

Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2016, Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit (DPS) ka realizuar progresin e mëposhtëm për objektivat:

1. Përafrimi i legjislacionit në fushën e standardizimit me atë të BE

- Është përgatitur draft Vendimi i Këshillit të Ministrave “Rregullore për Veprimtarinë e Standardizimit”, e cila transponon Rregulloren e BE nr.1025/2012 “Mbi Standardizimin Europian”. Kjo draft VKM është dërguar nga MZHETTS për miratim në Këshillin e Ministrave, e cila sipas PKIE 2016-2020 duhet të jetë miratuar e hyjë në fuqi brenda 6 mujorit të parë 2017.
- Janë miratuar, nga Bordi Drejtues i DPS, 9 Rregulloret e Brendshme të DPS, të cilat u përditësuan sipas ndryshimeve më të fundit të dy Rregulloreve të Brendshme të CEN dhe CENELEC Pjesa 2 “Rregulla të Përbashkëta për Punën e Standardizimit” dhe Pjesa 3 “Rregullat për strukturën dhe hartimin e standardeve të CEN/CENELEC”.

2. Adoptimi i Standardeve

- u adoptuan në total **2,984** standarde nga të cilat:

2,277 janë Standarde Europiane ose rreth 97% e totalit të standardeve të CEN dhe CENELEC;

707 janë Standarde Ndërkombëtare.

Janë adoptuar **100%** standardet europiane të harmonizuara si standarde Shqiptare të harmonizuara.

Problem mbetet adoptimi i tyre vetëm me përkthim të faqes së parë.

3. Komunikimi/Marrëdhëniet me publikun

- Të gjitha eventet e standardizimit janë publikuar online në www.dps.gov.al përfshirë këtu edhe takimet dhe dokumentat e miratuara nga Bordi Drejtues, rregulloret, buletinet, Katalogu i Standardeve Shqiptare, njoftime në Sekretariatit e ISO / IEC dhe CEFTA, artikuj të ndryshëm promovues, takimet me student dhe palë të interesuara, standardi më i ri i publikuar nga DPS.
- U realizua takimi me studentët e Fakultetit të Shkencave Pyjore të Universitetit Bujqësor të Tiranës në Kamëz
- Janë publikuar rreth 60 artikuj promovues dhe 120 ekstrakte të fushave për standarde me interes për biznesin dhe ekonominë.

- Numri i klikimeve është rritur ndjeshëm këtë vit krahasuar me vitet e kaluara - Në total janë marrë më shumë se **23,000 klikime** për publikimet në mediat sociale: [DPS facebook](#) [DPS Google](#) + dhe [DPS LinkedIn](#).
- Është publikuar dhe shpërndarë Katalogu i Standardeve Shqiptare 2016 në të dyja versionet me letër dhe me CD.
- Janë publikuar dhe shpërndarë 5 Buletinë Informativë;
- Janë notifikuar dhe bërë të disponueshme për publikun të gjitha draft aktet ligjore e nënligjore të ministrive të linjës me ndikim në tregti.

4. Përmirësimi i shërbimit ndaj qytetarëve

- U realizua në kohë dhe më cilësi përfshirja e shitjes online të Standardeve Shqiptare, gjë që rrit ndjeshëm përmirësimin e shërbimit ndaj biznesit dhe cdo pale tjetër të interesuar për standard, duke shkurtuar kohën dhe kostot e tyre për blerjen e standardeve.

5. Bashkëpunimi me homologët në fushën e standardizimit

- Është lidhur Marrëveshja e Mirëkuptimit me Administratën Kineze të Standardizimit, e cila konsiston në:
 - i. Shkëmbimin e dokumentave dhe informacionit në fushën e rregullave teknike dhe standardizimit;
 - ii. Trajnimin e stafit të DPS për përgatitjen dhe kompletimin e dosierit të kritereve për anëtarësim në CEN & CENELEC;
 - iii. Trajnimin e anëtarëve dhe kryetarëve të Komiteteve Teknike të DPS sipas praktikave më të mira në këtë fushë.